



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 999/1 Prot.

Tiranë, më 12/7/2018

V E N D I M

Nr. 151, Datë 12/7/2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 47, datë 17.04.2018, të bërë nga F.A kundër L.Z në cilësinë e Drejtores së shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” dhe F.M në cilësinë e Përgjegjëses të ZA Mallakastër në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak “bindjes politike” në formën e shoqërimit¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaroi se që nga viti 2014 deri në vitin 2016 ka qenë e punësuar si mësuese pranë shkollës “Ismail Klosi” me kontrata me afat të përcaktuar. Në Shtator 2016 ka nënshkruar kontratën e fundit si mësuese ndihmëse me fëmijët me aftësi ndryshe. Duke filluar nga muaji Janar 2018, ndjehet nën presion verbal dhe psikik nga drejtoresha e shkollës dhe Zyra Arsimore Mallakastër. Drejtoresha e shkollës e thërriste çdo ditë në zyrën e saj duke i kërkuar që të firmoste një kontratë me afat të përcaktuar (3 mujore). F.A deklaroi se nuk ka pranuar të firmosë kontratën dhe drejtoresha e kërcënoi me largim nga puna nëse nuk firmos kontratën. F.A informoi se ka bërë ankesë drejtuar ZA Mallakastër në të cilën ka shpjeguar se ndjehej nën presion nga drejtoresha e shkollës dhe po sulmohet politikisht për shkak të bindjeve politike. Në datë 06.04.2018 ka marrë njoftim nga drejtoresha e shkollës në të cilën njoftohej se i është ndryshuar kontrata e punës që në 15.03.2018. F.A shpjegoi se po sulmohet politikisht sepse bashkëshorti i saj është angazhuar politikisht në fushatë elektorale për subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”. Në vijim të komunikimit elektronik, ankuesja ka ngritur pretendimin se

¹ Referuar Çertifikatës Familjare nr. 012571471, datë 20.04.2018, F.A është bashkëshortja e A.A, aktivist dhe anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” referuar kartës së anëtarësisë nr.33493, datë 14.10.2016.

ka dhe mësues të tjerë² në shkollë dhe në ZA Mallakastër të cilët janë në situatë paligjshmërie por që nuk është marrë asnjë masë për ndryshimin e kontratave të punës.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe mosprishjen e kontratës së punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Pretendimi i ankueses se shkak për diskriminimin e saj është bindja politike dhe lidhja familjare me A.A, aktivist dhe anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” njësia Ballsh, që është bashkëshorti i F.A, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, F.A, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

² Mësueset: N.D, E.H, E.A, H.M dhe psikologia A.A.

- Me shkresën nr. 532/1, datë 27.04.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, ZA Mallakastër dhe Shkollës “Ismail Klosi” Ballsh, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga F.A.

Me shkresën nr. 60, datë 03.05.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, drejtorja e shkollës “I.Klosi”, në mes të tjerash ka informuar se: *“F.A është një ndër të shumtët mësues të emëruar jashtë çdo kriteri me urdhër të prerë nga të tjerë drejtues të ZA Mallakastër, dhe si drejtores ka përgjegjësinë e saj që ka pranuar të punojë nën presion. F.A nuk i është mohuar e drejta e ushtrimit të profesionit dhe nuk ka një sulm politik ndaj saj. Ndaj të gjithë emrave me shkelje që konstaton raporti i MASR-s qofshin këto me përvojë vitesh në punë, është marrë masë dhe po vazhdojnë punën normalisht me kontratë me afat të përcaktuar”*.

Me shkresën nr. 278/1, datë 03.05.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ZA Mallakastër, ka dërguar pranë Komisionerit kopje të dokumenteve të kërkuar në lidhje me pretendimet e subjektit ankues.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 95, datë 17.05.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Zyrës Arsimore Mallakastër dhe në shkollën “I.Klosi”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë këtyre institucioneve, më datë 24.05.2018, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Zyrës Arsimore Mallakastër, inspektorët e KMD-s, morën takim me F.M, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Arsimore.

Gjatë inspektimit F.M në mes të tjerash informoi se: *“Mësuesit të cilëve iu është ndryshuar kontrata pas raportit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë: S.Th, mësuese ndihmëse shkolla Bejar, pjesëmarrëse në portal, ndryshuar kontrata nga Drejtori i shkollës nga 1-vjeçare në 3-mujore sepse nuk ka pasur trajnime për fëmijët me AK. E.H, mësuese ndihmëse shkolla Meto, pjesëmarrëse në portal, ndryshuar kontrata nga 1-vjeçare në 3-mujore sepse nuk ka pasur trajnime për fëmijët me AK. A.B, mësuese ndihmëse shkolla “I.Klosi”, pjesëmarrëse në portal, ndryshuar kontrata nga 1-vjeçare në 3-mujore sepse nuk ka pasur trajnime për fëmijët me AK. B.M, mësuese ndihmëse shkolla Kutë, pjesëmarrëse në portal, ndryshuar kontrata nga 1-vjeçare në 3-mujore sepse nuk ka pasur trajnime për fëmijët me AK. E.R, mësuese ndihmëse shkolla “5 Shkurti”, ndryshuar kontrata nga 1-vjeçare në 3-mujore sepse nuk ka pasur trajnime për fëmijët me AK. G.A, mësuese Filozofi-Sociologji në gjimnazin “D.Hekali”, ndryshuar kontrata nga 1-vjeçare në 3-mujore sepse nuk ka portal profil Filozofi. S.H, emëruar si mësues ndihmës në shkollën Meto në Janar 2018 me kontratë 3-mujore, nuk ka trajnim për fëmijët me AK. E.S, emëruar si mësuese ndihmëse në shkollën Fratar në muajin Prill 2018 me kontratë 3-mujore, nuk ka trajnim për fëmijët me AK. F.A, mësuese ndihmëse shkolla “I.Klosi”, ndryshuar kontrata nga “me afat të pacaktuar” në 3-mujore sepse nuk ka marrë pjesë në asnjë nga portalet “Mësues për Shqipërinë”. Emërimi i mësuesve gjatë vitit 2016 është bërë sipas renditjes së konkurentëve të portalit të vitit 2015 dhe kanë vijuar sipas renditjes së portalit 2017. Profili i arsimit special në*

portalin e ZA Mallakastër mungon dhe të gjithë mësuesit e sipërpërmendur vijnë nga renditja sipas portalit të profilit të tyre. Nga data 14.09.2016 deri më sot në ZA Mallakastër në profilin mësuese ndihmëse, është emëruar me kontratë me afat të pacaktuar vetëm F.A, ndërsa si mësues ndihmës nga portali nga periudha 14.09.2016 deri më sot janë emëruar mësuesit: E.H, B.M, A.B, S.Th, E.R, S.H, E.S dhe të gjithë të sipërpërmendurit janë me kontrata pune 3-mujore. Gjatë vitit 2017 janë emëruar si mësues ndihmës me lëvizje të detyruar 2 mësues: V.Xh dhe Sh.A. Mësuesit: E.L, H.M dhe E.A janë emëruar me lëvizje të detyruar, si mësues ndihmës përpara daljes së Udhëzimit 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimin dhe largimin nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”. A.A me shkresën nr.5/76, datë 19.02.2018 është emëruar në detyrën si psikologe nga Bashkia Mallakastër pasi nuk është në kompetencën e ZA Mallakastër emërimi i psikologut të shkollës”.

Në lidhje me pretendimin e F.A se nuk i janë kthyer përgjigje ankesave të saja, E.T, mbajtëse e protokollit, informoi se: “Bazuar në librin e protokollit të mbledhjeve të ZA Mallakastër, znj.Alushaj ka qenë prezent në takimet e zhvilluara, por ka heshtur dhe nuk ka pasur diçka për të shënuar në protokoll”.

Gjatë inspektimit pranë shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi”, inspektorët e KMD-s, morën takim me L.Z, me detyrë drejtoare e shkollës, e cila në lidhje me mësuesit e përmendur në ankesë, informoi se: “Në shkollën “I.Klosi” punojnë 4 mësuese ndihmëse: EA, HM, AB dhe FA. Mësueset E.A dhe H.M janë emëruar si mësuese ndihmëse në datë 30.09.2015 me lëvizje të detyruar për arsye të mbylljes së vendit të punës në shkollat ku ato punonin. Mësuesja A.B ka filluar punë si mësuese me kontratë 9-mujore dhe pas raportit të MASR i është ndryshuar kontrata në 3-mujore. Mësuesja ND ka filluar punë si mësuese e lëndës Edukim Fizik në datë 10.01.2018 me kontratë 3-mujore, pasi është e profilit Biologji-Kimi dhe është pjesë e portalit. Mësuesi S.H ka filluar punë si mësues i lëndës Edukim Fizik në datë 10.01.2018 me kontratë 3-mujore pasi është i profilit Gjuhë-Letërsi dhe ka 16 vite eksperiencë pune si mësues. Mësuesja EH është emëruar si mësuese e lëndës Edukim Fizik me kontratë 3-mujore në datë 13.09.2017 me urdhër verbal të ish Drejtorit të ZA Mallakastër, E.D, por që nuk i është rinovuar kontrata dhe nuk është pjesë e sistemit arsimor. Mësuesja RZ ka filluar punë si mësuese e profilit Cikël i Ulët që në vitin 2008 në shkollën “Ahmet Ajazi” Greshicë dhe në vitin 2015 është transferuar në shkollën “I.Klosi”. Mësuesja i plotëson të gjitha kriteret për mësues që në vitin 2008, ndërsa për zhvillimin e saj profesional po ndjek studimet, Master i Shkencave në Mësuesi, pranë Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Mësuesja F.A është emëruar me kontratë me afat të pacaktuar në vitin 2016, pas urdhrit verbal të dhënë nga ish drejtori i ZA Mallakastër, jashtë kriterit të emërimit të mësuesit ndihmës, pa portal dhe pa trajnim për nxënësit me aftësi të kufizuara. Prishja e kontratës për F.A u bë pas raportit të MASR si për të gjithë mësuesit që ishin pjesë e raportit dhe për mësuesit e tjerë që nuk ishin përmendur në raport. Pas raportit të MASR janë ndryshuar apo nuk janë rinovuar kontratat për mësuesit: A.B (ndryshuar kontrata), G.B dhe E.H (nuk u është rinovuar kontrata). Për F.A nuk ka pasur asnjë trajtim të pabarabartë për shkak të bindjes

politike, pasi kam qenë kandidate për anëtare e Këshillit Bashkiak Mallakastër për subjektin politik LSI, e renditur e katërta në zgjedhjet vendore të vitit 2015”.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Ankuesja F.A, që nga data 15.11.2014 ka qenë e punësuar me kontrata me afat të caktuar si mësuese për lëndën e Edukimit Fizik pranë shkollës “Ismail Klosi”. Në datë 14.09.2016 ka lidhur kontratën individuale të punës, pa afat të caktuar si mësuese ndihmëse pranë shkollës “I.Klosi”. F.A zotëron: - Diplomë Universitare “Master Profesional” në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë-Letërsi, me profil minor në Gjuhë Italiane të lëshuar nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër në datë 18.07.2015, - Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin Gjuhë Shqipe dhe Letërsi pas dhënies së provimit të shtetit më datë 26.11.2015 dhe – Certifikatë trajnimi i barazvlefshëm me 1 kredit (18 orë trajnim) për përfundimin me sukses të trajnimit në programin “Tema ndërkurrikulare” me temë “Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin gjithëpërfshirës” të zhvilluar më datë 29.04.2018.

Me shkresën nr.11856/3, datë 07.12.2017 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar pranë ZA Mallakastër, “Raportin mbi verifikimin lidhur me zbatimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, në emërimet e mësuesve në ZA Mallakastër”, në të cilin në mes të tjerash shkruhet: “F.A është punësuar me kontratë me afat të pacaktuar si mësuese ndihmëse më datë 14.09.2016 në shkollën “I.Klosi”, Ballsh, pa marrë pjesë në asnjë nga portalet “Mësues për Shqipërinë””. Në përfundim të raportit, grupi i punës ka rekomanduar që, ZA Mallakastër dhe drejtoritë e shkollave të marrin masa për zbatimin me përpikmëri të procedurave të parashikuara në Udhëzimin nr.38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesve në institucionin publik të arsimit parauniversitar”.

Me shkresën nr.182, datë 15.03.2018 drejtuar shkollës “I.Klosi”, Përgjegjësjë e ZA Mallakastër³ ka kërkuar nga shkolla zbatimin e rekomandimeve të bëra nga raporti i MASR nr.11856/3, datë 15.03.2018.

Me shkresën nr.50, datë 18.04.2018 drejtorja e shkollës “I.Klosi” ka njoftuar F.A për tu paraqitur pas dy ditësh në drejtorinë e shkollës për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës. Me Vendimin nr.01, datë 24.04.2018 drejtorja e shkollës “I.Klosi” ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës të F.A si mësuese ndihmëse, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës më datë 07.06.2018 dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare pas përfundimit të lejes vjetore.

Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin për mësuesit ndihmës pranë shkollës “I.Klosi” rezultoi se: Në shkollën “I.Klosi janë të punësuar 4 mësuese ndihmëse: EA, HM, AB dhe FA. Mësuesja E.A e diplomuar si mësuese e profilit Gjuhë Shqipe-Letërsi, me 3 vjet vjetërsi në arsim, me Vendimin nr.11, datë 30.09.2015 është emëruar si mësuese ndihmëse pranë shkollës

³ Me Urdhrin nr.1806/2, datë 28.12.2017, F.M është urdhëruar të ushtrojë kompetencat e Përgjegjësit të ZA Mallakastër.

“I.Klosi”. Mësuesja H.M e diplomuar si mësuese e profilit Biologji-Kimi, me 4 vjet vjetërsi në arsim, me Vendimin nr.12, datë 30.09.2015 është emëruar si mësuese ndihmëse pranë shkollës “I.Klosi”. Mësuesja A.B me arsim të lartë, me vjetërsi në arsim 1 vit, me Shkresën nr.106, datë 13.09.2017 “Kontratë Individuale e Punës me afat të përcaktuar” është punësuar pranë shkollës “I.Klosi” për një 1 vit si mësuese ndihmëse, ndërsa me shkresën nr.9/1, datë 13.01.2018 të drejtorisë së shkollës “I.Klosi” i është ndryshuar kontrata e punës deri në datë 13.06.2018. Mësuesja F.A me arsim të lartë, me vjetërsi në arsim 2 vite, me Shkresën nr.101, datë 14.09.2016 “Kontratë Individuale e Punës pa afat të caktuar” është punësuar pranë shkollës “I.Klosi” pa afat si mësuese ndihmëse, ndërsa me Vendimin nr.1, datë 24.04.2018 të drejtorisë së shkollës “I.Klosi” i është zgjidhur kontrata e punës pasi nuk ka pranuar ndryshimin e saj.

Në Kreun 1, pika 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurim, i cili zhvillohet në tri faza: A. Konkurrim me dosje. B. Konkurrim nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”. C. Zgjedhja e vendit të punës”*. Ndërsa në Kreun 4, pika 4 dhe 9 “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit” të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“4. Kandidati emërohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë individuale pune me afat një vit kalendarik (periudhë prove). Kontrata nënshkruhet ndërmjet mësuesit dhe drejtorit të institucionit arsimor”* ndërsa në pikën 9 përcaktohet se: *“Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. Kandidati i punësuar sipas kësaj pike, nuk e humbet të drejtën për t’u njoftuar për të zgjedhur, sipas këtij kreu, si dhe ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës përpara afatit”*.

Në Kreun 7, pika 1 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Të gjithë mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, bëjnë kërkesë në njësinë arsimore vendore për lëvizjen paralele të detyrueshme....”*.

Në Kreun I, pika 1/a/b të Udhëzimit nr.38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” përcaktohet se: *“1. Mësuesi ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore publike duhet të plotësojë këto kritere: a) Të jetë pajisur me diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit b) Të ketë kryer trajnime të specializuara për trajtimin dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi/ diplomë që vërteton këtë kompetencë profesionale të shtuar”*.

Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara arrihet në përfundimin se për tu punësuar si mësues me afat të pacaktuar në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e caktuara në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit

dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, procedurë e cila në rastin e emërimit të F.A nuk është respektuar nga ana e shkollës “I.Klosi” dhe ZA Mallakastër dhe e konstatuar nga raporti i MASR.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se dhe mësueset e tjera ndihmëse në shkollën “I.Klosi” janë pa kualifikimet e duhura, Komisioneri vlerëson se bazuar në Kreun 7, pika 1 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore në përfundim të vitit shkollor kanë përparësi në punësimin e tyre si mësues duke ndjekur procedurat e punësimimit për lëvizje paralele të detyrueshme, sipas profilit të kualifikimit. Përsa më lart dhe mësueset EA dhe HM, janë emëruar nga shkolla “I.Klosi”, si mësuese ndihmëse që në vitin shkollor 2015-2016, pasi u është suprimuar pozicioni i punës në shkollat respektive ku ato ushtronin profesionin e mësuesit, ndërkohë që emërimi i mësueses ndihmëse AB nuk është bërë sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në udhëzimet e sipërcituara dhe për këtë arsye drejtoria e shkollës “I.Klosi” ka bërë dhe ndryshimin e kontratës së punës për këtë mësuese.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se në shkollën “I.Klosi” ka dhe mësues të tjerë që nuk plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit, Komisioneri vlerëson se nga ana e shkollës “I.Klosi” pas njoftimit të raportit të MASR, janë marrë masat për vënien në ligjshmëri të marrëdhënieve të punësimimit për mësuesit që ishin jashtë kriterëve, si në rastin e mësuesve: AB, GB dhe EH ndërkohë që mësuesja ND është e punësuar si mësuese e lëndës Edukim Fizik me kontratë me afat të përcaktuar nga data 10.01.2018 deri më 10.04.2018 dhe 10.04.2018 deri me datë 15.06.2018, pasi referuar shkresës nr.10/1, datë 09.01.2018 të ZA Mallakastër në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2017 nuk ka pasur aplikantë për mësues në profilin Edukim Fizik.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e shkollës “I.Klosi” dhe ZA Mallakastër, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankueses.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga drejtorja e shkollës “I.Klosi”, lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjes politike të bashkëshortit të F.A, vlerësohet se F.A ka patur marrëdhënie punësimi me kontrata me afat të caktuar dhe të pacaktuar me drejtorin e shkollës “I.Klosi” që prej vitit 2014, për më tepër dhe sipas pohimit⁵, .Z i përket të njëjtit subjekt politik si dhe bashkëshorti i F.A. Pra vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjykime apo trajtim të pabarabartë për shkak të bindjes politike të bashkëshortit të F.A nga ana e drejtores së shkollës “I.Klosi”.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i ankueses në raport me mësueset: EA, HM, AB, GB dhe EH pasi veprimet e shkollës “I.Klosi”, nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të trajtimit të marrëdhënieve të punësimit të F.A.

Lidhur me pretendimin e F.A se vetëm për të është ndryshuar kontrata e punës pas gjetjeve dhe rekomandimit të bërë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komisioneri vlerëson se, nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara gjatë inspektimit të datës 24.05.2018 nga ana e ZA Mallakastër dhe drejtoritë e institucioneve arsimore, janë marrë masat për vënien në ligjshmëri të marrëdhënieve të punësimit nëpërmjet ndryshimit të kontratës për mësuesit: S.TH, E.H, B.M, E.R, G.A, S.H dhe E.S.

Lidhur me pretendimin mbi punësimin si mësues ndihmës të mësuesve pa profilin e duhur në shkollat e ZA Mallakastër, Komisioneri vlerëson se për këto pretendime bazuar në Kreun III, neni 2⁶ të Udhëzimit Nr. 38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të

⁴ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁵ Referuar Proceçverbalit të inspektimit datë 24.05.2018.

⁶ “Zbatimi i kriterëve dhe procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit ndihmës, sipas përcaktimeve të këtij Udhëzimi, janë objekt i inspektimit të Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit”.

kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, duhet ti drejtoheni me shkrim Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit si institucioni përgjegjës për zbatimin e kritereve dhe procedurave të emërimit të mësuesit ndihmës.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e ZA Mallakastër dhe shkollës “Ismail Klosi” Ballsh në drejtim të ndryshimit të marrëdhënieve të punësimit të F.A nuk kanë qenë diskriminuese, pasi përmbushja e kritereve ligjore për emërimin e mësuesve ndihmës nuk përbën trajtim më pak të favorshëm.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases F.A, për shkak të bindjes politike të bashkëshortit të saj, nga ana e Zyrës Arsimore Mallakastër dhe shkollës “Ismail Klosi” Ballsh.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: bindja politike)
(fusha: punesim)